

FTESE PËR OFERTË

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: **22 Maj 2026**

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “*Mjedisi në sytë e të rinjve (N’SJ)*” mbështetur nga Bashkia e Tiranës. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti organizata kërkon të realizojë procedurën e prokurimit e thjeshtë për “**Shërbim Transporti për Pjesëmarrësit (4 destinacione)**”

Kushtet për pjesëmarrje:

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **22 Maj 2026**, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në adresën Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Specifikimet teknike:

Për këtë projekt, Milieukontakt Shqipëri do të zhvillojë procedurën për ofrimin e shërbimit të transportit sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Transport për 20 pjesëmarrës në 4 destinacione	Shërbim Transporti	Çmimi/njësi Lekë
1	Qëndër - Liqeni Farkes	1	
2	Qëndër - Liqeni Bovillës	1	
3	Qëndër - Lumi Tiranës (Pranë Paskuqanit)	1	
4	Qëndër - Shkalla Tujanit	1	
	Total		

Shërbimi i transportit do të realizohet gjatë periudhës **Maj-Qershor**, sipas planifikimit të aktiviteteve të projektit.

Ofertuesi duhet të garantojë se:

- Disponon mjete transporti të përshtatshme për **20 persona** (minibus/autobus)
- Mjetet janë në gjendje të mirë teknike dhe përmbushin standardet e sigurisë
- Shoferët janë të licencuar dhe me eksperiencë
- Garanton transportin vajtje-ardhje për secilin destinacion
- Përfshin të gjitha kostot (karburant, taksa rrugore, shërbim, etj.)
- Ka fleksibilitet në orare sipas nevojave të aktivitetit

Kushte të përgjithshme:

- Të jetë i regjistruar si subjekt tregtar sipas legjislacionit në fuqi
- Të ketë status aktiv (NIPT)
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi
- Të ketë eksperiencë në ofrimin e shërbimeve të transportit

Pagesa do të kryhet me transfertë bankare pas përfundimit të shërbimit dhe dorëzimit të faturës përkatëse.

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **22 Maj 2026**, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në Adresën Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruktion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Pagesa e subjektit/personit fizik do të kryhet me transfertë bankare pas përfundimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse, ose si subjekt i tatimit mbi të ardhurat (15%) sipas legjislacionit shqiptar.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit te kontaktit. Krahas ofertës financiare të plotësuar sipas tabelës në ftesë (në Lekë), duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

1. Ofertë financiare (sipas tabelës)
2. Ekstrakt i QKB / ID (nëse është person fizik)
3. Numri i llogarisë bankare

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

AUTORITETIT KONTRAKTOR
Milieukontakt Shqipëri